



INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELFGOVERNMENT

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËRKORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBUN PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI – CORRUPTION AGENCY



KONKURS

Titulli i postit: Shef i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit

Shifra e postit: DPK-3.01

Koeficienti i postit: 10

Paga: 326 €

Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti i Mbikëqyrjes udhëhiqet nga Shefi i Departamentit të Mbikëqyrjes së Pasurive, Konfliktit të Interesave dhe Pranimit të Dhuratave i cili nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Agjencionit ushtron përgjegjësitë e më poshtme:

- Udhëheq dhe mbikëqyr punën e udhëheqësve të divizioneve, mbikëqyr punën e zyrtarëve dhe stafit tjetër mbështetës në këtë departament me qëllim të ushtrimit me efektivitet të plotë të përgjegjësive që i caktohen me nenin 30 të këtij Akti, me Ligjin Kundër Korrupsionit si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
- Shërben si Këshilltar i Drejtorit të Agjencionit në çështjet e mbikëqyrjes së pasurive, konfliktit të interesave dhe pranimit të dhuratave nga ana e personave zyrtar të lartë,
- Bashkëpunon me organet e auditivit dhe organet tjera përgjegjëse për luftimin e korrupsionit nga lëmi i kompetencave të këtij departamenti,
- Ndërmerr veprimet e nevojshme në funksion të efikasitetit dhe zhvillimit të këtij departamenti,
- Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga Drejtori në kuadër të mandatit të tij.

Kualifikimet e nevojshme:

- Kandidati duhet të jetë jurist i diplomuar;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvoja në hartimin dhe interpretimin e legjislacionit,
- Kandidati duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me legjislacionin në fuqi,
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm ose e gatshme të punojë jashtë orarit nëse është e nevojshme,
- Të jetë banor i përhershëm i Kosovës,
- Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm,
- Njohja e punës me kompjuter Word-i, Excell-i, interneti, përpunimi i tekstit dhe përgatitja e raporteve buxhetore e prezantimeve janë të domosdoshme.
- Kërkohet njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe dhe /ose e gjuhës serbe, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

INFORMATAT E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Kohëzgjatja e kontratës për të gjitha postet është 3 vjet me periudhë provuese tremujore dhe me mundësi vazhdimi Agjensioni Kosovar i Kundërkorrupsionit ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave. Politika e punësimit të drejtë të gjitha komuniteteve të Kosovës, do të zbatohet në strukturën e stafit të Agjencionit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistimit.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Formulari për konkurrim mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovarë Kundërkorrupsionit në Prishtinë (rruga "Bajram Kelmendi" nr. 31). Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me letër motivimin dëshminë për kualifikimin shkollor, specializimin, kurset e ndjekura, përvoja e punës dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuara me të dhënat e kërkuara, si dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, do të konsiderohet i pavlefshëm.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikuar në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kërkesa mund të dozohet në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovarë Kundërkorrupsionit në Prishtinë (rruga "Bajram Kelmendi" nr. 31) ose me postë, si dhe në Zyrën e Personelit nr .09 kati i dytë. Për informata shtesë mundë të telefononi në telefonin: 038 248 563 lok 118.

Vërejtje: Dokumentet nuk kthehen